

LIGJI Nr. 03/L-029

## PËR INSPEKSIONIN BUJQËSOR

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

## LIGJ PËR INSPEKSIONIN BUJQËSOR

### KREU I

#### Dispozitat e përgjithshme

##### Neni 1 Qëllimi

Me këtë ligj përcaktohet puna, kompetencat, detyrimet dhe përgjegjësitë e inspektorit.

##### Neni 2 Përkufizimet

Përkufizimet dhe shprehjet të përdorura me këtë ligj kanë këto domethënie:

“**Organi inspektues**” nënkupton organin e autorizuar të Ministrisë për ushtrimin e kontrollit zyrtar sipas ligjit;

“**Inspektori**” nënkupton personin e autorizuar sipas ligjit për ushtrimin e inspektimit;

“**Mbikëqyrja inspektuese**” mbikëqyrja e aktiviteteve dhe veprimeve të personave fizik dhe juridik në zbatimin e ligjit dhe akteve tjera nënligjore të nxjerra në bazë të ligjit;

“**Kontrolli inspektues**” nënkupton aktivitetin e inspektorit gjatë inspektimit;

“**Organizata profesionale**” subjekti i autorizuar për kryerjen e analizave, super analizave dhe punëve tjera të përcaktuara me ligj;

“**Inspekcioni i ministrisë**” nënkupton inspektionin e nivelit qendrorë;

“**Inspekcioni komunal**” nënkupton inspektionin të nivelit lokal;

“**Ministria**” nënkupton Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

“**Ministri**” Ministrin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

##### Neni 3 Fushëveprimi

1. Inspektori kryen punët inspektuese në fushat e bujqësisë:

- 1.1. tokat bujqësore;
- 1.2. pylltarisë dhe gjuetisë;
- 1.3. mbrojtjes së bimëve;
- 1.4. blegtorisë dhe peshkatarisë;
- 1.5. veterinarisë dhe sigurisë së ushqimit.

## **KREU II**

### **Neni 4 Organizimi i inspektionit**

1. Inspekcioni është organ ekzekutiv në kuadër të Ministrisë.
2. Inspekcioni përbëhet nga:
  - 2.1. inspekcioni për tokën bujqësore;
  - 2.2. inspekcioni për pylltari dhe gjueti;
  - 2.3. inspekcioni për mbrojtjen e bimëve, inspekcioni fitosanitar;
  - 2.4. inspekcioni për blegtori dhe peshkatari;
  - 2.5. inspekcioni për veterinari dhe siguri të ushqimit.
3. Punën e inspektorit e kryen vetëm personi i cili posedon përgatitjen superiore të drejtimit përkatës dhe përvojën e caktuar profesionale.

### **Neni 5 Kompetencat e Inspektionit**

1. Mbikëqyrjen inspektuese e kryejnë inspektorët e nivelit qendror në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Inspektorët komunal kryen inspektimin brenda territorit të komunës sipas autorizimeve ligjore.

### **Neni 6 Punët e Inspektorit**

1. Inspektori në punën e tij është i pa varur brenda autorizimeve të përcaktuara me ligj dhe akteve të nxjerra në bazë të ligjit.
2. Inspektori gjatë punës së tij harton procesverbale, bien vendime, ndërmerr masa dhe veprime në kuadër të të drejtave, detyrimeve dhe autorizimeve të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.

### **Neni 7 Të drejta, detyrat dhe autorizimet e Inspektorit**

1. Varësisht nga fusha e inspektionit, inspektori:
  - 1.1. bën kontrollin e hapësirave afariste, objektet, pajisjet, veglat, mjetet, prodhimin, përpunimin, qarkullimin, transportin, eksportin, importin, riekportin dhe kalimin transit të mallrave;

- 1.2. kërkon vërtetimin e identitetit të personave si dhe faktet tjera;
  - 1.3. bënë shikimin e akteve, evidencës dhe dokumentacionit tjetër të nevojshëm;
  14. merr mostrat e mallit dhe mjeteve tjera për analiza, ekspertizë dhe superanalizë;
  - 1.5. merr në pyetje dhe merr deklarata nga personi përgjegjës dhe personat tjerë;
  - 1.6. zbaton procedurën lidhur me kërkesat e qytetarëve dhe subjekteve tjerë dhe për veprimet e ndërmarra e njofton paraqitësin e kërkesës;
  - 1.7. propozon masat preventive me qëllim të parandalimit të shkeljeve të dispozitave ligjore;
  - 1.8. ndërmerr edhe veprime të tjera për të cilat është i autorizuar me ligj;
2. Inspektori nuk mund të jetë anëtar i komisionit apo organit tjetër për përcaktimin e kushteve për veprimtarinë afariste.

### **Neni 8** **Autorizimet e veçanta të Inspektorit**

1. Kur inspektori konstaton se është shkelur ligji dhe dispozitat tjera të nxjerra nga ligji është i autorizuar dhe detyrohet të:
- 1.1. urdhëroi ndërmarrjen e masave dhe veprimeve përkatëse për evitimin e parregullsive dhe mangësive në afatin e përcaktuar;
  - 1.2. urdhëron dorëzimin e dokumentacionit dhe të dhënave tjera brenda afatit të përcaktuar;
  - 1.3. merr përkohësisht pajisjet, mjetet dhe dokumentacionin e nevojshëm;
  - 1.4. urdhëron hapjen e dhunshme të objektit për qëllime të inspektimit;
  - 1.5. urdhëron mbylljen e dhunshme të objektit;
  - 1.6. merr mallin e dyshimtë apo të prishur, ndërsa mallin i cili paraqet rrezik për shëndetin publik e asgjëson;
  - 1.7. urdhëron tërheqjen e mallit të dyshimtë nga qarkullimi, përkatësisht vënies së tij në qarkullim;
  - 1.8. urdhëron tërheqjen e dokumentacionit të prodhimit i cili nuk është i harmonizuar me dispozitat ligjore, gjegjësisht urdhëron evitimin e mangësive të produktit;
  - 1.9. ndalon ushtrimin e veprimtarisë, përkatësisht kryerjen e punëve të caktuara, për kohë të caktuar;
  - 1.10. ndalon përdorimin dhe shfrytëzimin e mjeteve të punës, njësive punuese, pajisjeve prodhuese, qarkullimin dhe përdorimin e mallit kur nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj.
  - 1.11. ndërmerr veprime të mostrimit, kontrollimit dhe shqyrtimit të produktit për qëllime të verifikimit dhe harmonizimit me dispozitat ligjore në fuqi;
  - 1.12. ndërmerr masa për evitimin e rrezikut për jetën, shëndetin e njerëzve dhe shëndetin e kafshëve apo mbrojtjes së interesit publik;

1.13. inicion procedurën kundërvajtjese dhe ushtron fletëparaqitje penale dhe

1.14. merr edhe veprime të tjera për të cilat është i autorizuar me ligj.

2. Ndalesën nga nën- paragrafët 1.9. dhe 1.10. paragrafi 1 i këtij neni inspektori e realizon nëpërmjet bllobimit, vulosjes, mbishkrimit apo vënies së shiritit.

### **Neni 9 Vendimet**

1. Për masat nga neni 8 i këtij ligji inspektori merr vendim.

2. Përgjithësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, masat dhe veprimet nga neni 8 i këtij ligji inspektori i paraqet vetëm me procesverbal kur vlerëson se në këtë mënyrë evitohet rreziku i drejtpërdrejt për jetën dhe shëndetin e njerëzve kafshëve ose pasurisë me përmasa të gjëra dhe kur është në interes publik.

3. Për veprimet nga paragrafi 2 i këtij neni, inspektori në afat prej njëzetekatër (24) orëve merr vendim.

### **Neni 10 Ankesa kundër vendimit të Inspektorit**

1. Kundër vendimit të inspektorit pala ka të drejtë ankese ministrisë në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të vendimit;

2. Ankesa kundër vendimit të inspektorit nuk e ndalon ekzekutimin, përveç nëse me ligj nuk parashihet ndryshe.

3. Konkluzionin për lejimin e ekzekutimit të vendimit e nxjerrë inspektori në afat prej tetë ditëve nga dita kur vendimi të bëhet i ekzekutueshëm.

4. Shpenzimet e ekzekutimit të vendimit i bartë pala e cila ka qenë e detyruar që t'i zbatoi masat e urdhëruara.

## **KREU III**

### **Neni 11 Raportet e Inspektionit bujqësor të ministrisë me Inspektionin komunal**

Bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve ndërmjet inspektionit të ministrisë dhe inspektionit komunal rregullohet me akte nënligjore.

## **KREU IV**

### **Neni 12 Kontrolli inspektues**

1. Kontrolli në zbatimin e dispozitave ligjore realizohet nëpërmjet kontrollit të rregullt dhe të jashtëzakonshëm.

2. Kontrolli i rregullt realizohet në pajtim me Planin e punës të Inspektionit të cilin e miraton Ministria.

3. Kontrolli i jashtëzakonshëm realizohet në bazë të urdhërësave të veçanta, kërkesave dhe ankesave të qytetarëve apo personave tjerë.

4. Procedura sipas kërkesave dhe ankesave është urgjente.

### **Neni 13**

1. Inspektimet kryhen në praninë e personit përgjegjës apo personit të autorizuar i cili njoftohet për pasojat juridike apo lëshimet procedurale.
2. Në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj, inspektori bënë inspektimin edhe pa prezencën e personit përgjegjës.
3. Personi ndaj të cilit bëhet inspektimi detyrohet që inspektorit ti mundësoi qasje të pa penguar në inspektim, t' i japi informata dhe të vejë në shikim tërë dokumentacionin dhe të dhënat tjera të nevojshme të cilat i kërkon inspektori.

### **Neni 14**

1. Kur inspektori gjatë inspektimit nuk e takon personin përgjegjës të subjektit ndaj të cilit bëhet mbikëqyrja inspektuese, inspektimi bëhet në prezencën e personit të autorizuar nga radha e të punësuarve, të cilën inspektori e konstaton me procesverbal.
2. Kur nuk mund të bëhet inspektimi sipas paragrafin 1 të këtij neni, inspektori në vendin e inspektimit në selinë e subjektit e lenë thirrjen për personin përgjegjës që në kohën dhe vendin e caktuar të jetë prezent gjatë inspektimit.
3. Dëmtimet e mëvonshme, asgjësimi dhe eliminimi i ftesës nuk ndikojnë në rregullsinë e dorëzimit.
4. Kur pala e ftuar përgjegjëse nuk i përgjigjet thirrjes nga paragrafi 2 i këtij neni, inspektimi bëhet në prezencën e personave të takuar në subjekt.

### **Neni 15**

#### **Bashkëpunimi me institucionet profesionale**

1. Inspektori në kryerjen e inspektimit mund të kërkon ndihmën dhe bashkëpunon me institucionet profesionale dhe ekspertët të fushës përkatëse.
2. Punët e caktuara tekniko-profesionale si ekspertizë, hulumtime laboratorike, mund të kryhen në institucionet e specializuara.

### **Neni 16**

1. Në rastet kur Inspektori, në kryerjen e inspektimit, pengohet ose i pamundësohet inspektimi, kërkon ndihmën e Policisë së Kosovës.
2. Për rastet nga paragrafi 1 i këtij neni inspektori mundet të shqiptoi masën e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë.

### **Neni 17**

#### **Procesverbali për kontrollin inspektues**

1. Për çdo kontrollim inspektues për veprimet dhe masat e ndërmarra inspektori harton procesverbal.
2. Në raste të caktuara, për shkak të vëllimit dhe ndërlikueshmërisë së mbikëqyrjes inspektuese kur nuk është e mundur të hartohet procesverbal, procesverbali hartohet në zyre të inspektorit në afat prej tri ditëve nga dita e inspektimit.
3. Procesverbali i dërgohet subjektit ndaj të cilit është bërë inspektimi.

4. Procesverbalin e nënshkruajnë të gjithë personat të cilët marrin pjesë gjatë kontrollit inspektues.

#### **Neni 18**

Inspektori mbanë evidencën për kontrollet inspektuese.

#### **Neni 19**

##### **Legjitimacioni i inspektorëve**

1. Inspektori gjatë kryerjes së inspektimit e mbanë legjitimacionin dhe uniformën me të cilën tregon cilësinë e inspektorit, identitetin dhe autorizimet.
2. Inspektori, gjatë orarit të punës dhe gjatë inspektimit detyrohet të mbanë uniformën.
3. Përmbajtjen dhe formën e legjitimacionit, emblemës dhe uniformës e përcakton ministria me akt nënligjor.

#### **Neni 20**

##### **Ekzekutimi i masave të urdhëruara**

1. Inspektori përçjell ekzekutimin e masave të cilat i ka urdhëruar gjatë inspektimit dhe për të njëjtat i paraqet raport ministrisë.
2. Subjekti ndaj të cilit është kryer inspektimi detyrohet që në afat prej tri ditëve nga dita e skadimit të afatit për ekzekutimin e masës së propozuar t'a njoftoi me shkrim inspektorin se është zbatuar masa e propozuar .

#### **Neni 21**

##### **Ekzekutimi i dhunshëm**

1. Kur masat e urdhëruara kanë të bëjnë me zbatimin e veprimeve të caktuara ndërsa subjekti ndaj të cilit bëhet mbikëqyrja nuk i ka zbatuar në afatin e paraparë, apo pjesërisht i ka zbatuar, urdhërohet ekzekutimi i dhunshëm i masave.
2. Subjekti njoftohet me shkrim për kohën dhe mënyrën e ekzekutimit të dhunshëm.
3. Ekzekutimin e dhunshëm nga paragrafi 1 të këtij neni e zbaton organi i cili e ka urdhëruar ekzekutimin.
4. Shpenzimet e ekzekutimit të masave i bartë subjekti ndaj të cilit zhvillohet ekzekutimi.

#### **Neni 22**

1. Kur gjatë inspektimit e cakton masën për marrjen e sendit apo mjetit i cili mund të shërbej si provë apo është përdorur, dedikuar apo shkaktuar me veprime të kundërligjshme, cakton vendin dhe mënyrën e ruajtjes deri me dorëzimin organit i cili udhëheqë procedurë.
2. Organi apo organizata e cila caktohet për deponimin dhe ruajtjen e mjeteve sipas paragrafit 1 të këtij neni i pranon mjetet e marra dhe mallin në ruajtje deri me vendimin përfundimtarë, apo me kërkesën e ministrisë. Për marrjen e mallit në ruajtje organi apo organizata lëshon vërtetim.
3. Po qe se malli i marr është i rrezikuar nga prishja apo dëmtimi i shpejtë apo kur ruajtja e tij shkakton shpenzime të mëdha, inspektori kërkon nga ministria që të merr vendim për shitjen e tij. Me vendimin për shitjen njoftohet organi kompetent për udhëheqje të procedurës.
4. Kundër vendimit për shitjen e mallit-sendeve – lejohet ankesa.

5. Kur vendimi për shitjen e mallit-sendeve- priset me vendimin e shkallës së dytë, personit të cilit i është marr malli i kompensohet dëmi.
6. Për marrje të mallit apo sendeve sipas këtij neni inspektori lëshon vërtetim me të gjitha shënimet e sakta të sasisë, kualitetit dhe llojit të mallit.
7. Mjetet financiare nga shitja e mallit sipas këtij neni derdhen në Buxhetin e Kosovës.

### **Neni 23 Marrja e mostrës**

1. Inspektori në procedurën e inspektimit merr mostrën për verifikimin e kualitetit të lëndës për analizë.
2. Procedurat e marrjes së mostrave përcaktohen me akt nënligjor.

### **Neni 24**

1. Në procedurën e marrjes së mostrës të produktit inspektori ka të drejtë dhe obligim:
  - 1.1. me të njëjtat kushte dhe në të njëjtën kohë, për shqyrtimin e kualitetit të të njëjtit produkt, në mënyrë të rregullt merë së paku tri mostra në sasi të nevojshme për analizën e parë, superanalizë dhe për palën;
  - 1.2. secilën mostër në mënyrë adekuate e vulosë dhe e shënon;
  - 1.3. harton procesverbal për marrjen e mostrës dhe një kopje ia dorëzon palës;
  - 1.4. mostra e marre për analizën e parë, pa vonesë i dorëzohet Laboratorit referent, kurse mostra rezervë të ruhet sipas kushteve të parapara deri me përfundimin e analizës.
  - 1.5. pala nga e cila është marrë mostra njoftohet me rezultatet e analizës;
  - 1.6. me kërkesën e palës, ministria pa vonesë e dërgon mostrën për superanalizë.
  - 1.7. shpenzimet e analizës dhe superanalizës sipas kërkesës së palës i bartë pala;
  - 1.8. shpenzimet e analizës dhe superanalizës sipas detyrës zyrtare varësisht nga rezultatet e analizës nëse ato rezultojnë negativ i bartë ministria, ndërsa nëse ato rezultojnë pozitiv, i bartë pala.

### **Neni 25**

1. Rezultatet e analizës kontestohen me rezultatet e superanalizës.
2. Analiza dhe superanaliza e të njëjtës mostër nuk mund të bëhet në të njëjtin institucion.
3. Personat fizik dhe juridik detyrohen që pa pagesë të vejnë në disponim sasinë e nevojshme të lëndës për analiza;

### **Neni 26 Përgjegjësia e Inspektorit**

1. Inspektori për punën e vet është përgjegjës:
  - 1.1. nëse gjatë inspektimit nuk ndërmerr, nuk propozon apo nuk i përcakton masat për të cilat është i autorizuar ti ndërmerr;
  - 1.2. nëse nuk propozon apo nuk e inicion procedurën pranë organeve kompetente për vërtetimin e veprimeve të kundërligjshme;

1.3. nëse i tejkalon autorizimet e përcaktuara me ligj;

1.4. nëse nuk vepron në pajtim me Kodin e mirësjelljes për nëpunësit civil dhe etikës së inspektorit;

1.5. nëse me gabimet e tija i shkakton dëme materiale dhe jo materiale subjektit ndaj të cilit e bën inspektimin;

1.6. nëse nën ndikimin e personit nuk i ndërmerri masat të cilat sipas ligjit është i detyruar t'i ndërmarri.

2. Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni kundër inspektorit iniciohet procedura disiplinore sipas kërkesës së përgjegjësit të drejtpërdrejt.

#### **Neni 27 Përparësia në inspektim**

1. Konfliktet në mes të inspektorëve shqyrtohen me procedurë urgjente në afat prej tri ditëve nga dita e paraqitjes së konfliktit.

2. Për konfliktin e kompetencave vendosë ministria vendimi i së cilit është përfundimtarë.

#### **Neni 28 Mbikëqyrja e përbashkët**

Ministria me akt nënligjor i përcakton rregullat me të cilat më për së afërmi përcaktohet organizimi dhe funksionimi i inspektimit të përbashkët.

### **KREU V DISPOZITAT NDËSHKIMORE**

#### **Neni 29 Kundërvajtjet**

Dënimet me gjobë për kundërvajtje dhe lartësia e dënimit për personat fizik, personat juridik dhe personat përgjegjës aplikohen dispozitat ndëshkimore të ligjeve në fuqi.

#### **KREU VI Neni 30 Dispozitat përfundimtare**

Ministria, në afat prej 9 (nëntë) muaji nga dita e miratimit, nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

#### **Neni 31**

1. Të hyrat e realizuara nga ky ligj derdhen në Buxhetin e Kosovës.

2. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave me Memorandum të Mirëkuptimit mund të rregullojnë shfrytëzimin e mjeteve të realizuara për nevoja të Ministrisë.



## **KREU VII**

### **Neni 32 Hyrja në fuqi**

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-029  
20 Nëntor 2008**

**Shpallur me Dekretin Nr. DL-065-2008, datë 13.12.2008 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,  
Dr. Fatmir Sejdiu.**